

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE PRANË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me objekt “*Mbi zbatimin e përputhshmërisë, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën 01.01.2014 deri më 30.09.2015 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH Nr. 180, datë 30.12.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën Nr. 784/5, datë 30.12.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. Arben Ahmetaj, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1. Nga auditimi i zonave ekonomike rezultuan mangësi në drejtim të akteve nënligjore, që rregullojnë aspekte të caktuara në funksion të ligjit nr. 54/2015, datë 28.05.2015 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9789, datë 19.07.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”*”, kryesisht mbi funksionimin, administrimit dhe monitorimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, në drejtim të:

- Afateve kohore të dorëzimit të sipërfaqeve të zonave ekonomike nga subjektet zhvillimore, apo përdorues, në rastet ndërprerjes së kontratave nga ana e MZHETTS për mos respektim të kushteve të saj;

- Tarifës së pagesës që duhet të kryejë çdo subjekt zhvillues ose përdorues në institucion, për marrjen e licencës zhvillimore, të ardhura që rezultojnë nga objekti i veprimtarisë të institucionit të parashikuara në Ligjin nr. 54/2015 datë 28.05.2015.

- Detyrimin e çdo përdoruesi të zonës që ushtron aktivitet ekonomik, të lejojë të drejtën e ushtrimit të kontrollit jo vetëm të autoriteteve doganore dhe tatimore, por dhe të inspektoratit të mjedisit, si organ i specializuar në këtë fushë me qëllim mbrojtjen e mjedisit, florës dhe faunës;

- Procesit të mbikëqyrjes së eliminimit të mallrave, apo mbetjeve që rezultojnë të rrezikshme në çdo zonë ekonomike nga MZHETTS, duke mos përfshirë Autoritetet Doganore, Ministrinë e Mjedisit, të cilat në bashkëpunim organet e rendit mund të sigurojnë garancinë e këtij procesi.

- Nga auditimi i statusit aktual për Zonat Ekonomike rezultoi se nga viti 2008 e në vazhdim janë shpallur me VKM 9 “*zona ekonomike*”, nga të cilat 7 janë “*parqe industriale*”. Referuar nenit 17 të Ligjit nr. 54/2015, datë 28.05.2015 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9789, datë 19.07.2007*”, sipas të cilit thuhet se dispozitat e këtij ligji zbatohen për zonat ekonomike me status “*zonë teknologjike dhe e zhvillimit ekonomik*” dhe të shpallura pas hyrjes në fuqi të tij, nuk është përcaktuar si do funksionojnë veprimtaritë në 7 zona ekonomike të shpallura nga viti 2008 me status tjetër atë të “Park industrial”. Kjo vështirëson monitorimin e investimeve të këtyre zonave ekonomike nga MZHETTS, pasi objekt i veprimtarisë së institucionit MEI janë parqet energjetike e industriale dhe MZHETTS ka objekt të veprimtarisë zonat teknologjike dhe të zhvillimit ekonomik, (Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqen nr. 58-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MZHETTS të marrë masa për plotësimin e akteve nënligjorë mbi funksionimin, administrimin dhe monitorimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, duke pasqyruar edhe aspektet e mëposhtme:

- Të përcaktohen afatet kohore të dorëzimit të sipërfaqeve të zonave ekonomike nga subjektet zhvillimore apo përdorues, në rast të ndërprerjes së kontratave nga ana e MZHETTS për mos respektim të kushteve të saj;

- Të përcaktohet tarifa e pagesës që duhet të kryejë çdo subjekt zhvillues ose përdorues në institucion, për marrjen e licencës zhvillimore mbi të ardhurat që rezultojnë nga objekti i veprimtarisë të institucionit të parashikuara në Ligjin nr. 54/2015 datë 28.05.2015;
- Të përcaktohen detyrimet e përdoruesit të zonës, për çdo zonë ekonomike për të cilën çdo subjekt zhvillues ushtron aktivitet ekonomik, të drejtën e ushtrimit të kontrollit ta kenë jo vetëm autoritetet doganore dhe tatimore, por dhe inspektorati i mjedisit si organ i specializuar në këtë fushë me qëllim mbrojtjen e mjedisit, florës dhe faunës;
- Në procesin e mbikëqyrjes së eliminimit të mallrave, apo mbetjeve që rezultojnë të rrezikshme në çdo zonë ekonomike, të ketë një procedurë transparente dhe të mirëmonitoruar krahas MZHETTS, të përfshihen edhe Autoritetet Doganore, Ministria e Mjedisit.
- Për zona ekonomike me status “*Park industrial*”, të cilat janë në fazën e fillimit të investimit, monitorimi i kontratave të subjekteve zhvillimore të rregullohet dhe të zgjidhet me ndërhyrje ligjore që të kryhet vetëm nga 1(një) institucion, me çdo të sigurojë rritje të përgjegjësisë institucionale në monitorim..

Në vijimësi

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2014 deri në dt. 30.09.2015, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) *drejton procesin e monitorimit të kontratave të qirasë dhe enfiteozës*, të lidhura për objekte shtetërore, ndërsa njësitë monitoruese të cilat administrojnë këto objekte, kanë detyrimin e monitorimit të drejtpërdrejtë, në zbatim të VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014, “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”, i ndryshuar, kapitulli VI “*Monitorimi i kontratave*”. Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore në MZHETTS monitoron, gjithsej 67 kontrata qiraje, nga të cilat 25 kontrata qiraje janë të lidhura para vitit 2002, referuar legjislacionit të kohës, ku në detyrimet kontaktore nuk janë saktësuar të drejtat dhe detyrimet e dyanshme, duke u fokusuar më shumë vetëm në pagesat mujore gjë që vështirëson monitorimin e këtyre kontratave. Ndërsa për pjesën tjetër të kontratave të qirasë në të cilat janë paraqitur detyrimet kontraktore të shoqëruara me aplikim penalitetesh *në rastet e mos përmbushjes së detyrimeve* janë evidentuar problematikat e mëposhtme:

-Nga MZHETTS, nuk është marrë asnjë masë administrative ndaj njërive monitoruese që administrojnë pronën publike të cilat janë mjaftuar me informacione periodike vetëm për pagesat mujore duke mos realizuar monitorimin e nivelet të investimit apo të punësimit.

-Nga Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, nuk janë kryer monitorime fizike në objektet me qira për realizimin e treguesve të punësimit dhe investimit, të marrë përsipër në kontratë, si detyrime të subjektit qiramarrës. Gjatë periudhës së auditimit me Urdhrin e Ministrit nr. 6840, datë 08.09.2015 është ngritur *grupi i punës për ushtrimin e kontrollit për kontratat e qirasë dhe enfiteozës* por deri në momentin që u hartua material i auditimit, nuk u paraqit asnjë informacion, për ecuritë e kontrollit.

-Sektori i monitorimit të kontratave të qirasë nuk ka burimet e duhura njerëzore për të realizuar monitorimin e kontratave të qirave.

-Në pjesën më të madhe të dosjeve fizike të audituara mungojnë planimetritë (*genplanet*) me përmasat e caktuara të objektit të dhënë me qira.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”, i ndryshuar, kapitulli VI “*Monitorimi i kontratave*”, pasi (MZHETTS) drejton procesin e monitorimit të kontratave të qirasë dhe enfiteozës, të lidhura për objektet shtetërore, (*Për sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr. 58-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e MZHETTS/Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, të realizohen monitorime të vazhdueshme, ndaj njërive monitoruese që administrojnë pronën publike si dhe të hartohet raporti

mbi produktin e punës të grupit të ngritur me Urdhrin e Ministrit të MZHETTS nr. 6840, datë 08.09.2015.

Të merren masa administrative ndaj njësive monitoruese që administrojnë pronën publike, për mos monitorimin e kontratave për realizimin e nivelet të investimit apo të punësimit për objektet e dhëna me qira.

Në vijimësi

2. Nga auditimi rezulton se, treguesit e nivelit të investimeve të kontratave të mësipërme, janë më të larta se ato të marra përsipër, vlera këto të dala nga pasqyrat financiare të vitit 2014 të miratuara nga ekspertët kontabël të autorizuar. Vlera totale e paraqitur në bilancet e konsoliduara bën të pamundur identifikimin dhe vlerësimin e investimit të marrë përsipër sipas kontratës. Këto bilance financiare janë të pa shoqëruar me raportin e vlerësimit të investimit për objektin e marrë me qira, nga shoqëria qiramarrëse, ndonëse nga ana e MZHETTS, është kërkuar me shkresa zyrtare në mënyrë të vazhdueshme, plotësimi i dokumentacionit shoqërues. (Për sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr.68-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e MZHETTS, të merren masat që, të gjitha subjektet qiramarrëse, pavarësisht numrit të aktiviteteve që kryejnë, për objektet e marra me qira, të paraqesin në shënimet e pasqyrave financiare, vlerën e investimeve të kryera dhe numrin e të punësuarve, të certifikuara nga ekspertët kontabël të autorizuar.

Në vijimësi

3. Nga auditimi mbi detyrimin e pagesave që shoqëritë me pronar shtet, të cilat sipas kontratave të qirasë kanë detyrimin të derdhin 30% për llogari të MZHETTS, për vitin 2014 dhe për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015 rezultoi e pa likuiduar vlera prej **4,490,655** lekë, nga shoqëritë si më poshtë:

1. “Prodhim Veshje Ushtarake” sh.a. Tiranë, pa likuiduar vlerën prej 1,490,080 lekë,
2. “KEPUCA” sh.a. Korçë, rezulton pa likuiduar vlerën prej 225,360 lekë,
3. “Uzina 12”, Elbasan, rezulton pa likuiduar vlerën prej 533,666 lekë,
4. “Prodhim Mobilje” sh.a. Tiranë, rezulton, pa likuiduar vlerën prej 2,241,549 lekë, (Për sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr.68-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e MZHETTS (Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike), të arkëtohet detyrimi i papaguar në vlerën totale prej **4,490,655** lekë, që shoqëritë e mësipërme kanë detyrimin të derdhin 30% për llogari të MZHETTS, sipas kontratave të qirasë.

Brenda 3/mujorit të parë 2016

4. Nga auditimi i procedurave të dhënies me qira me tarifë 1 euro/kontrata, rezultoi se;

a. Nga shoqëritë shtetërore, të cilat kanë një numër të konsiderueshëm të pronave publike, nuk ekziston databaze për to. Propozimet për dhënie me qira nga njësitet që administrojnë pronën shtetërore, kanë ardhur me arsyetimin se gjendja ekonomike dhe financiare e këtyre shoqërive me kapital 100% shtetëror, nuk janë efikase, e për rrjedhojë është kërkuar dhënia e aseteve të tyre me qira.

b. Mbas lidhjes së kontratave të qirasë, njësitet që administrojnë pronën publike, nuk realizojnë një proces të plotë monitorimit. Këto njësi mjaftohen vetëm me monitorimin e pagesave mujore që kryhen nga Administratorët e këtyre shoqërive shtetërore, dhe jo në monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratës.

c. Nga ana e MZHETTS, nuk ekziston një data-baze, ku në bashkëpunim me Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, të bëhet evidentimi i të gjithë objekteve pronë shtetërore të mundshme për t’u dhënë me qira, duke i promovuar në formë elektronike në Eëb-in e MZHETTS, para bizneseve vendase apo të huaja, si një mundësi për zhvillimin e aktivitetit ekonomik të vendit.

d. Nga auditimi është konstatuar se nuk ka patur “garë konkurruese” pasi është paraqitur vetëm një subjekt në garë.

e. Në pjesën më të madhe të kontratave të lidhura me tarifë simbolike 1 euro/kontrata, për pjesën e monitorimit, në kushtet e kontratave është e shprehur, se monitorimi fillon mbas 1 vit të hyrjes në

fuqi të kontratës, duke i dhënë mundësi subjektit qiramarrës të plotësojë angazhimet e marra, në kontratat e qirasë respektive.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, kapitulli V “Kontrata me tarifë simbolike 1 euro/kontrata”, (Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqen nr.68-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e MZHETTS, në bashkëpunim me Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, të krijohet një data-baze, ku të evidentohen të gjithë objektet pronë shtetërore të mundshme për t’u dhënë me qira, paraqitja e tyre në Ëeb-in e MZHETTS për ti promovuar para bizneseve vendase, apo të huaja, si një mundësi për zhvillimin e aktivitetit ekonomik të vendit.

Mbas lidhjes së kontratave të qirasë, njësitë që administrojnë pronën publike, duhet të realizojnë një proces të plotë monitorimi jo vetëm për kryerjen e pagesave mujore, por për zbatimin në tërësi të kushteve të kontratës.

Në vijimësi

5. Nga auditimi i dosjes me kontratën e qirasë nr. 2946 Rep dhe 154 Kol, e lidhur më datë 04.06.2002 midis ish METE-s dhe shoqërisë “I” sh.p.k., i ndryshuar rezultoi se kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me VKM nr. 430, datë 09.07.1998 “Për dhënien me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive ose institucioneve shtetërore”, pasi në momentin e lidhjes së kontratës së qirasë sipërfaqja e identifikuar si pronë private me Certifikatën për Vërtetim Pronësie nr. 137889, Zona Kadastrale nr. 8603 me sipërfaqe totale prej 6410,5 m² nuk është ndarë nga sipërfaqja totale e dhënë me qira, (Për sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr.68-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MZHETTS, të rishikojnë kontratën e qirasë me nr. 2946 Rep dhe 154 Kol, e lidhur më datë 04.06.2002 midis ish METE-s dhe shoqërisë “I” sh.p.k., i ndryshuar për sipërfaqen e identifikuar si pronë shtetërore.

Në vijimësi

6. Nga auditimi i shoqërive **me kapital mbi 50%** shtetëror rezultoi se, nga Sektori i Menaxhimit të Shoqërive Publike, mbështetur në analizën e **ekspertëve kontabël** për vitet e mëparshme, nuk ka propozime para mbylljes së vitit ushtrimor për listën e audituesve kontabël që do të auditojnë pasqyrat financiare të këtyre shoqërive. Shkresat e emërimit të tyre janë nisur në datën 22 janar 2015, pra mbas mbylljes së inventarizimit të aseteve të shoqërive (sh.a.). Kjo vonesë në emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar ka penguar dhënien e opinionit të drejtë për aktivet e qëndrueshme të shoqërive, të cilët nuk kanë sigurinë e nevojshme për vlerën e këtyre aseteve, siç e përshkruajnë edhe vetë audituesit në bazat e opinionit me rezervë: “Ne nuk kemi marrë pjesë në inventarizimin fizik të gjendjes materiale dhe të inventarëve, për shkak se kjo datë, ishte para angazhimit tonë si auditorë dhe si rezultat, nuk jemi në gjendje të përcaktojmë efektin kontabël që mund të vijë nga ky veprim”.

Për sa më lartë është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjin nr.9228, datë 29.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe në rregulloren e brendshme të MZHETTS, (Për sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr. 29-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

-Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike/Sektori i Menaxhimit të Shoqërive Publike, për të shmangur parregullsitë në vlerën e aseteve dhe të inventarëve të pasurisë së paluajtshme të shoqërive (sh.a) me kapital shtetëror mbi 50%, **të propozojë para muajit nëntor të çdo viti listën e ekspertëve kontabël të autorizuar**, të cilët do të certifikojnë pasqyrat financiare të vitit ushtrimor dhe miratimi i tyre nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve (firmosur nga Ministri), të përfundojë brenda muajit nëntor të vitit ushtrimor.

-Të përfshihen në listat e ekspertëve kontabël për shoqëritë (sh.a.) me kapital shtetëror mbi 50%, ekspertë me kapacitet të spikatur dhe me përvojë në këtë profesion. Të kërkohet në mënyrë periodike vlerësimi i punës së tyre nga bordi i mbikëqyrjes publike të eksperteve kontabël për të

garantuar cilësi të auditimit të kryer në interes të shtetit, sidomos për shoqëritë me interes të lartë shtetëror.

Në vijimësi

7. Nga auditimi i shoqërive me kapital shtetëror **mbi 50%**, rezultoi se:

a. Në katër shoqëri (sha), pasqyrat financiare të vitit 2014, të audituara nga ekspertët kontabël e të miratuara nga Këshillat Mbikëqyrëse, janë paraqitur me vonesë, në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike, si “KESH” sh.a, Tiranë në datë 20.07.2015, “Alminiera” sh.a, Tiranë në datë 23.07.2015, “Porti Detar, Shëngjin” në datë 17.07.2015 dhe “Tregu me shumicë i Fruta Perimeve” Vlorë, në datën 27.07.2015.

b. Nuk janë miratuar nga MZHETTS/Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike pasqyrat financiare të audituara nga ekspertët kontabël e të miratuara nga Këshillat Mbikëqyrëse për shoqëritë: “Alpetrol” sh.a, Tiranë, “Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a, Tiranë, “Kripa” sh.a Vlorë, “Prodhim këpuca e trikotazhi” sh.a, Korçë dhe “Tregu i shitjes me shumicë fruta perime” sh.a, Shkodër.

c. Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a, Tiranë, krahasuar me vitin e mëparshëm ka një rritje të konsiderueshme të gjithë treguesve financiarë, kryesisht në të ardhurat, duke rezultuar me një fitim prej 229,699,353 lekë dhe një ndarje dividendi, në vlerë 22,969,935 lekë për buxhetin e shtetit, vlerë e cila është derdhur nga kjo shoqëri. Raporti i Ekspertëve Kontabël të autorizuar ka dhënë në bazën për opinionin me rezervë një sërë vërejtje sugjerime e rekomandime për pasqyrat financiare të këtij viti, të cilat nga strukturat drejtuese të shoqërisë nuk janë marrë parasysh.

d. Shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST), Tiranë, ka një rritje të gjithë treguesve nga një vit më parë dhe si rezultat, edhe dividendi i llogaritur ruan po ato kuota rritjeje. Ka rezultuar me një rritje fitimi, krahasuar me një vit më parë për 324,918,484 lekë. Edhe këtë vit derdhja e dividendit për llogari të MZHETTS-it, në vlerë 160,619,284 lekë, **nuk është realizuar**. Raporti i Ekspertëve Kontabël të autorizuar, ka dhënë opinionin me rezervë: “Aktivet afat gjata në lidhje me huatë dhe kreditë e shoqërisë, nuk janë paraqitur me vlerën e drejtë në momentin fillestar të marrjes së tyre dhe më pas me koston e amortizuar, sipas kërkesave të SNK 39. Megjithëse shoqëria ka dhënë informacion në shënimet shpjeguese për vlerën e drejtë të kredive në 31.12.2013 dhe në 31.12.2014, nuk jemi në gjendje të përcaktojmë efektin kontabël që mund të vijë si pasojë e vlerësimit të aktiveve financiare me vlerën e drejtë që në momentin fillestar, si dhe llogaritjen e koston së amortizuar më pas”, por nga shoqëria nuk është kthyer përgjigje për këto rekomandime, (Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqen nr.30-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Asambleja e Ortakëve/Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike/Spektori i Menaxhimit të Shoqërive Publike, në analizën që u bën këtyre shoqërive, të kërkojë:

-Afate për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga audituesit e pavarur dhe në rastet e mosplotësimit të këtyre rekomandimeve dhe afateve, të vendosin marrjen e masave administrative ndaj strukturave drejtuese të këtyre shoqërive.

-Të kërkojë marrja e masave të nevojshme, të cilat bëjnë të mundur derdhjen e dividendit të pa derdhur, ose sistemimin e tij.

Brenda 6/ mujorit të vitit 2016

8. Në vitin 2014, kanë rezultuar dhe janë miratuar me humbje **6 shoqëri (sh.a.)**, në vlerë **22,317,498 mijë lekë**, kur një vit më parë këto 6 shoqëri kanë rezultuar me fitim në vlerë 7,977,061 mijë lekë. Për këto shoqëri, të cilave u ndryshon rezultati pozitiv brenda një viti, nuk ka një analizë të hollësishme, ku të jenë përcaktuar përgjegjësitë dhe koha e zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes së tyre financiare.

Peshën më të madhe në këtë humbje për vitin 2014, e zë rezultati financiar i shoqërisë “Korporata Energjetike Shqiptare (KESH)” sh.a, në vlerë 22,240,664 mijë lekë, ose 99.6% të gjithë humbjes së këtyre shoqërive. Raporti i Ekspertëve Kontabël të autorizuar ka dhënë bazën e opinionit me rezervë me një sërë vërejtjesh e rekomandimesh për pasqyrat financiare të këtij viti për të cilat shoqëria ka kthyer përgjigje, por pa përcaktuar afate për realizimit e këtyre rekomandimeve, (Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqen nr. 43-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Analiza e rezultatit financiar të këtyre shoqërive, kryesisht KESH sh.a, duhet të jetë prioritet i Asamblesë së Ortakëve dhe Ministrisë së Energjetikës, duke analizuar shkaqet e kësaj humbje dhe saktësisë së këtij rezultati.

Administratorëve të shoqërisë t'u kërkohet një analizë e hollësishme, ku të jenë përcaktuar përgjegjësitë për rezultatin financiar shoqëruar me hartimin dhe miratimin e një strategjie për përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërisë.

Në vijimësi

9. Nga auditimi rezultoi se **19 shoqëri sh.a.** me kapital 100% shtetëror, dalën çdo vit me rezultat negativ (humbje) dhe mbartja e këtij rezultati negativ për këto shoqëri në vitin 2015, është në vlerën 5,273,185 mijë lekë. Për vitin 2014, në shumën e humbjeve prej 864,983 mijë lekë, peshën specifike më të madhe e ka shoqëria “*Hekurudha shqiptare*” sh.a. me 75% ose 644,195 mijë lekë. Për vitin 2014, këto shoqëri kanë rritur humbjen me 357,494 mijë lekë ose 68% krahasuar me vitin e mëparshëm dhe rezultati financiar negativ (*humbja*) prej 5,273,185 mijë lekë që trashëgohet për këto shoqëri në vitin 2015 do të ndikojë në zvogëlimin e kapitalit të këtyre shoqërive me pronar shtetin. (Për sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr. 45-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga MZHETTS-it, **të përcaktohet një strategji** për marrjen e masave të domosdoshme për të mundësuar daljen nga treguesit negativë të këtyre shoqërive, duke marrë në konsideratë mundësinë e subvencionimit të përkohshëm të disa prej tyre dhe për pjesën tjetër të shoqërive, për të cilat është e pamundur arritja e rentabilitetit, të shikohet mundësia e privatizimit të tyre.

Brenda vitit 2016

10. Shteti shqiptar, nëpërmjet (MZHETTS) në **13 shoqëri (sh.a) ka aksione nën 50%** të kuotës së këtyre shoqërive. Ministria si aksionar i pronarit shtet, në shumicën e këtyre shoqërive, ka kërkuar privatizimin e kuotave që ka në secilën prej tyre, duke thirrur disa herë mbledhjen e aksionarëve. Për shkak të problematikave që kanë shoqëruar këto shoqëri me vite, nuk është realizuar vlerësimi i kuotave të ortakut shtetëror, pasi nuk jepet miratimi në parim i ortakut që zotëron shumicën e aksioneve (mbi 50%), apo aksionerit kryesor për blerjen e këtyre aksioneve. Këto shoqëri në mbledhjet e asamblesë, duke zotëruar shumicën e aksioneve vendosin për miratimin e pasqyrave financiare dhe ndryshimin e kapitalit të shoqërisë, duke zvogëluar aksionet shtetërore.

Problematikat e ndryshme gjyqësore me të tretë, pengimi i ekspertëve të autorizuar për vlerësimin e kuotave apo aksioneve shtetërore, niveli i humbjeve të tyre si rezultat i keq menaxhimit, janë disa nga shkaqet që kanë sjellë zvarritjen e procesit të vlerësimit të kuotave të aksioneve shtetërore.

-Shoqëria “**Armo**” sh.a, Tiranë me 15% kuota shtetërore, të cilës këtë vit nuk i janë miratuar pasqyrat financiare, rezulton me një humbje prej 74,725 mijë lekësh, nga 208,817 mijë lekë humbje në vitin 2013. Kjo shoqëri vazhdon aktivitetin, duke mos miratuar propozimin për privatizimin e kuotave shtetërore.

-Shoqëria “**Albtelekom**” sh.a, Tiranë, me 16.8% kuota shtetërore së cilës këtë vit nuk i janë miratuar pasqyrat financiare, pasi i është kërkuar shoqërisë një relacion shpjegues lidhur me shkaqet e daljes së shoqërisë me humbje prej 2,005,754 mijë lekësh, të cilin shoqëria në fjalë nuk e ka dërguar. Kjo shoqëri edhe në vitin 2013 ka rezultuar me humbje prej 2,496,731 mijë lekë. Kjo shoqëri vazhdon aktivitetin, duke mos miratuar propozimin për privatizimin e kuotave shtetërore.

-Të gjitha shoqëritë me kapital shtetëror nën 50%, kanë të njëjtat problematika të konstatuar një vit më parë, megjithëse shteti shqiptar i përfaqësuar nga MZHETTS, u ka kërkuar këtyre shoqërive privatizimin e aksioneve të veta, nuk ka arritur të finalizojë asnjë prej tyre, për shkak të problematikave të trashëguara me pronësinë e tokës, ndryshimin e aksionarëve, apo të proceseve të zgjatura gjyqësore të shumë prej tyre, (Për sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr. 48-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MZHETTS, si aksionar i pronarit shtet, të marrë masat e nevojshme ligjore për parandalimin e zhvlerësimit të kuotave shtetërore dhe pjesës së kapitalit kjo duke vënë në lëvizje të gjithë mekanizmat shtetëror që do të garantonin një vlerësim të drejtë të situatës së pronësisë së tyre.

Brenda 6/mujorit të parë 2016

11. Shteti shqiptar nëpërmjet MZHETTS është aksionar në **19 shoqëri** (sh.p.k) me kapital shtetëror **nën 50%** dhe **1 shoqëri** është **me 81.83%** kapital shtetëror. Këto shoqëri janë krijuar kryesisht në vitet 1993-1996, ku disa prej tyre kanë pësuar dëmtime dhe kanë ndërprerë aktivitetet prej vitit 1997.

Nga 20 shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), 10 prej tyre janë në proces privatizimi, dy janë në likuidim, dy janë në sekuestro konservative, një në proces gjyqësor dhe katër vijojnë të punojnë normalisht. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në vitin 2014 ka nxjerrë urdhrat e privatizimit të gjitha shoqërive të përbashkëta dhe shumica e këtyre shoqërive janë në procedurë vlerësim kuotash.

Të gjitha shoqëritë (sh.p.k) kanë të njëjtat problematika të konstatuara një vit më parë, megjithëse shteti shqiptar i përfaqësuar nga MZHETTS, u ka kërkuar këtyre shoqërive privatizimin e aksioneve të veta, nuk ka arritur të finalizojë asnjë prej tyre, për shkak të problematikave të trashëguara me pronësinë e tokës, ndryshimin e aksionarëve, të keq menaxhimit të tyre, apo të proceseve të zgjatura gjyqësore të shumë prej tyre, (Për sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr. 50-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

MZHETTS si aksioner i pronarit shtet, të marrë masat e nevojshme ligjore për parandalimin e zhvlerësimit të kuotave shtetërore dhe pjesës së kapitalit në shoqëritë (sh.p.k) me aksione shtetërore nën 50% dhe realizimin e privatizimit nëpërmjet shitjes të këtyre kuotave.

Brenda vitit 2016

12. Nga auditimi rezultoi se deri më 30.09.2015 janë **9 shoqëri (sh.a & sh.p.k) debitoare** për mos derdhjen e dividendit, në vlerën **4,695,533,435** lekë. Disa nga këto shoqëri (sh.a) megjithëse çdo vit dalin me rezultat pozitiv dhe u është miratuar dividendi për t'u shpërndarë sipas ligjit, nuk e kanë derdhur atë me arsyetimin e vështirësive të mëdha financiare, paftësisë së tyre pague dhe marrëdhënieve financiare të komplikuar midis tyre. Këto shoqëri janë kryesisht shoqëritë e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilat përbëjnë dhe pjesën më të madhe të dividendit të miratuar për tu shpërndarë.

Subjektet debitoare (sh.a. & sh.p.k.) në analizë dhe shkaqet e mos derdhjes së dividendit si më poshtë:

Në lekë

Nr	Emërtimi i shoqërive Sha dhe Shpk	Dividendi i pa derdhur para vitit 2014	Disidenti i pa derdhur deri më 30.09.2015 për llogari të vitit 2014	Shuma e dividendit i pa derdhur deri më 30.09.2015
1	Alpetrol sha, Patos	1,527,353,392	x	1,527,353,392
2	Alba filmi sha, Tiranë	2,626,420	0	2,626,420
3	Hec ulëz sha, Shkopet	66,065,035	0	66,065,035
4	KESH sha, Tiranë	2,451,885,639	0	2,451,885,639
5	OST sha, Tiranë	468,760,149	160,619,284	629,379,433
6	Trans Albania shpk, Tiranë	0	5,083,281	5,083,281
7	Disco bar Lux shpk, Tiranë	0	66,307	66,307
8	Coca Cola shpk, Tiranë	0	4,163,784	4,163,784
9	QZHK Tiranë shpk, Tiranë	0	8,910,144	8,910,144
	Shuma	4,516,690,635	178,842,800	4,695,533,435

-“**Albpetrol**” sh.a, Patos, ka detyrime të pa derdhura të dividendit për llogari të pasqyrave financiare para vitit 2014, në vlerën **1,524,353,392** lekë, ose 32.5% të totalit të detyrimit për të derdhur, ndërsa pasqyrat financiare të vitit 2014, nuk janë miratuar akoma. Pasqyrat financiare të shoqërisë janë certifikuar nga Ekspertët Kontabël të Autorizuar të emëruar nga MZHETTS, të cilët kanë paraqitur opinionin e tyre me rezervë dhe për këtë shoqërisë “Albpetrol” sh.a. i është kërkuar shpjegim rreth konstatimeve të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar gjatë certifikimit të pasqyrave financiare të vitit 2014, për normat e amortizimi, diferenca në inventarë, në llogaritjen e provigjoneve etj. “Pas shpjegimeve të mësipërme do të procedojmë me miratimin e bilancit kontabël të vitit 2014”. Deri në periudhën e auditimit, nuk është marrë përgjigje nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. për çka është kërkuar në këtë shkresë. Arsyeja e moslikuidimit të dividendit sipas

drejtueseve të këtyre shoqërive është paaftësia paguese e shkaktuar nga mos likuidimi i faturave nga Kompania ARMO Tiranë.

-“**Hec Ulëz-Shkopet**” sh.a, Burrel, tani kaluar në pronësi kompanisë “K. I.” ka detyrime të pa derdhura të dividendit për llogari të Ministrisë, në vlerën **66,065,035** lekë, ose 1.4% të totalit të detyrimit për të derdhur. E gjithë shuma i takon detyrimit të pa derdhur para vitit 2014 (i përket vitit 2012). MZHETTS i është drejtuar Drejtorisë së Tatimeve Tiranë për arkëtimin e kësaj shume nga shoqëria “K. I.” si pronar i HEC.

-“**Korporata Elektro- Energjetike Shqiptare (KESH)**” sh.a, Tiranë, ka detyrime të pa derdhura të dividendit në vlerën **2,451,885,639** lekë (345,188,564 lekë për degën e tatim taksave dhe 2,106,697,075 lekë për llogari të Ministrisë), ose 52.2% të totalit të detyrimit për të derdhur, të cilat janë detyrime para llogarive vjetore të vitit 2014. Për vitin 2014 kjo shoqëri ka rezultuar me rezultat financiar negativ ku Raporti i Ekspertëve Kontabël të autorizuar, ka dhënë bazën e opinionit me rezervë; për llogaritë e arkëtueshme nga klientët, nga të cilat 51,694,081 mijë lekë janë të pa arkëtuara më shumë se një vit më parë dhe shoqëria nuk ka parashikuar zhvlerësim. Për vlerën 974,013 mijë lekë nuk kemi fituar një siguri të arsyeshme për saktësinë e saj dhe si rrjedhojë, nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin e korigjimit të mundshëm të pasqyrave financiare. Shoqëria nuk ka krijuar provizion në lidhje me çështjet gjyqësore në proces.

Shoqëria në përgjigjen për rekomandimet e lëna tregon vështirësitë dhe ecurinë e rregullimit dhe sistemimit të tyre, por pa një afat të realizimit të këtyre rekomandimeve.

Drejtorja e Administrimit të Pronës, informon Ministrin për shkaqet e gjendjes financiare të kësaj shoqërie, duke vënë theksin se kjo shoqëri për këtë vit, **ka realizuar më pak të ardhura se një vit më parë për 14,156,636 mijë lekë dhe ka shpenzuar më shumë se një vit më parë për 16,924,594 mijë lekë, tejkallim i cili ka ardhur vetëm nga provizionimi i klientëve pa shpresë arkëtimi dhe në procese gjyqësore në masën 19,653,430 mijë lekë.** Arsyeja e mos likuidimit të dividendit sipas drejtueseve të këtyre shoqërive është paaftësia paguese e shkaktuar nga, mos likuidimi i faturave nga shoqëria “OSHEE” Tiranë si dhe blerja e energjisë nga HEC-et private më shtrenjtë dhe shitja OSHEE –së më lirë.

-“**Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë (OST)**” sh.a, Tiranë, ka detyrime të pa derdhura të dividendit për llogari të Ministrisë, në vlerën **629,379,433** lekë, ose 13.4% të totalit të detyrimit për të derdhur, të ndara; para vitit 2014, në vlerë 468,760,149 lekë dhe për llogaritë vjetore të vitit 2014 në vlerën 160,619,284 lekë. Kjo shoqëri për vitin 2014 megjithëse ka një rritje të gjithë treguesve nga një vit më parë dhe ka rezultuar me një rritje fitimi krahasuar me një vit më parë, nuk ka realizuar derdhjen e dividendit për llogari të MZHETTS-it, në vlerë **160,619,284** lekë. Raporti i Ekspertëve Kontabël, ka dhënë opinionin me rezervë: “Aktivet afat gjata në lidhje me huat dhe kreditë e shoqërisë, nuk janë paraqitur me vlerën e drejtë në momentin fillestar të marrjes së tyre dhe më pas me koston e amortizuar dhe se nuk jemi në gjendje të përcaktojmë efektin kontabël që mund të vijë si pasojë e vlerësimit të aktiveve financiare me vlerën e drejtë që në momentin fillestar, si dhe llogaritjen e koston së amortizuar më pas. Nuk ka rekomandim, drejtuar Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit të shoqërisë për mosdakortësitë. Arsyeja e moslikuidimit të dividendit sipas drejtueseve të këtyre shoqërive është paaftësia paguese e shkaktuar nga mos likuidimi i detyrimeve nga OSHEE Tiranë.

-“**Alba film**” sh.a, Tiranë, ka detyrime të dividendit të pa derdhura për llogari të Ministrisë, në vlerën **2,626,420** lekë, ose 0.1% të totalit të detyrimit për të derdhur, të cilat janë detyrime para llogarive vjetore të vitit 2014. Arsyeja e moslikuidimit të dividendit sipas drejtueseve të këtyre shoqërive është paaftësia paguese e shkaktuar nga, mungesa e aktivitetit dhe privatizimi i objekteve të dhëna me qira.

-“**Trans Albania**” sh.p.k, Tiranë, ka detyrime të pa derdhura të dividendit në vlerën **5,083,281** lekë, ose 0.1% të totalit të detyrimit për të derdhur, të cilat janë detyrime të llogarive vjetore të vitit 2014.

-“**Disco bar Lux**” sh.p.k., Tiranë, ka detyrime të pa derdhura të dividendit, në vlerën **66,307** lekë, të cilat janë detyrime të llogarive vjetore të vitit 2014.

-“Coca Cola” sh.p.k., Tiranë, ka detyrime të pa derdhura të dividendit në vlerën **4,163,784** lekë, ose 0.1% të totalit të detyrimit për të derdhur, të cilat janë detyrime të llogarive vjetore të vitit 2014.

-“Qendra e Zhvillimit Kulturor” sh.p.k, Tiranë ka detyrime të pa derdhura të dividendit, në vlerën **8,910,144** lekë, ose 0.2% të totalit të detyrimit për të derdhur, të cilat janë detyrime të llogarive vjetore të vitit 2014, (Për sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr. 51-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

a. MZHETTS, si përfaqësuese e vetme e pronarit shtet të marrë masat e nevojshme për monitorimin e vazhdueshëm dhe arkëtimin e dividendit të pa derdhur nga shoqëritë në buxhetin e shtetit të rezultuar në pasqyrat financiare të vitit 2014, në vlerën prej **178,842,800** lekë dhe vlerën **4,516,690,635** lekë, dividend të pa derdhur në buxhetin e shtetit të rezultuar në pasqyrat financiare para vitit 2014.

b. MZHETTS, si përfaqësuese e vetme e pronarit shtet të marrë masat e nevojshme, për arkëtimin e detyrimeve të ndërsjella nga shoqëritë duke mundësuar ngritjen e një grupi ekspertësh për të zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshjet që kanë mes tyre në marrëdhëniet financiare të viteve të kaluara shoqëritë që prodhojnë dhe shpërndajnë energji.

Brenda vitit 2016

13. Nga auditimi i strukturës dhe organikës u konstatua se, ka mosplotësim të organikës të Sektorit të Zonave Ekonomike, pasi nga 3 persona në organikë me 1 përgjegjës sektori të miratuar me Urdhër nr. 43, datë 26.03.2015, në fakt rezulton se në këtë sektor punon 1 specialist. Mungesat në organikë rrisin riskun dhe ndikuar ndjeshëm në procesin e monitorimit të zonave ekonomike, subjektet zhvilluese dhe kontratat e lidhura.

-Në institucion mungon një database me të dhëna për çdo zonë ekonomike sipas subjekteve zhvilluese, referuar kontratave të lidhura sipas VKM, sipërfaqet e zonave, vlera e investimit, afatet kohore të investimit dhe të kontratave të zhvilluesit për të krijuar dhe plotësuar inventarin e pronave shtetërore të dhëna nga MZHETTS në zbatim të Ligji nr. 9789, datë 19.07.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, i ndryshuar me Ligjin nr. 54/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9789, datë 19.07.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike, (Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqen 58-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga MZHETTS, Sektori i Zonave Ekonomike të krijohet një database me të dhëna për çdo zonë ekonomike, sipas subjekteve zhvilluese referuar kontratave të lidhura sipas VKM, si sipërfaqet e zonave, vlera e investimit, afatet kohore të investimit dhe të kontratave të zhvilluesit duke krijuar dhe plotësuar kështu inventarin e pronave shtetërore të dhëna nga MZHETTS në zbatim të Ligjit nr. 9789, datë 19.07.2007.

Menjëherë

14. Nga auditimi i veprimtarisë së shoqërive më kapital tërësisht ose pjesërisht shtetëror, referuar opinioneve të dhëna nga raportet e ekspertëve kontabël të autorizuar, u konstatuan problematika të cilat shpesh vijnë si rezultat i një raportimi financiar jo të plotë, e kjo për shkak se auditimi i kryer nga ekspertët kontabël bazohet kryesisht në SNA 200, sipas së cilës objektivi i auditimit të Pasqyrave Financiare është t'i japë mundësi audituesit të shprehë një opinion nëse Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale sipas kuadrit të zbatueshëm të raportit financiar, dhe jo në përputhje me SNA 250 që i referohet përgjegjshmërisë së audituesit gjatë auditimit të pasqyrave financiare, lidhur me verifikimin e zbatueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera rregullatore nga njësia ekonomike, të cilat mund të jenë:

-Investigimet mbi pagesat e gjobave apo të penaliteteve; blerjet me çmime që dukshëm janë mbi ose nën çmimet e tregut; transaksionet e paautorizuara, ose transaksione të regjistruara në mënyrë të papërshtatshme; komentet e medias, apo raste të mashtrimit.

-Konstatohet se nga auditimi i veprimtarisë së shoqërive më kapital tërësisht ose pjesërisht shtetëror, opinionet në raportet e ekspertëve kontabël të autorizuar bien ndesh me raportet e audituesve shtetërorë të KLSH. (Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqen 28-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Për auditimin e Pasqyrave Financiare nga ekspertët kontabël të miratuar të shoqërive (sh.a. dhe sh.p.k.), Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si përfaqësuese e vetme e pronarit shtet, kur ka mbi 50% të aksioneve në këto shoqëri, **duhet të përfshijë në kontratat dhe letrat e angazhimit**, që në opinionin e dhënë audituesit e autorizuar kontabël, të shprehen në mënyrë specifike si për **SNA 200**, pra nëse Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale sipas kuadrit ligjor të raportimit financiar edhe për **SNA 250**, lidhur me verifikimin e zbatueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera rregullatore nga njësia ekonomike. Këto kërkesa mbështetur edhe në standartet **ISSAI 100** “*zbatimi i saktë i standardeve të pranueshme të kontabilitetit, duhet të rezultojë në paraqitjen e drejtë të pozicionit financiar dhe rezultateve të veprimtarisë*”.

Në vijimësi

C. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Nga auditimi i kontratave të qirasë me status monitorimi në vazhdim, të lidhura mbas vitit 2005, rezultoi se qiramarrësit nuk kanë realizuar treguesit për investim dhe punësim, detyrim ky sipas kontratave, nenit 5 (Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit), “Në rast të mos realizimit të treguesve për investimin dhe punësimin sipas pikave (...) të këtij neni, Qiramarrësi detyrohet t’i paguajë Qiradhënësit penaltitet në masën 10% të vlerës së investimit të pakryer për çdo vit, deri në realizimin e plotë të tij dhe 50.000 lekë për çdo punonjës të papunësuar”. Për mosrealizimin e treguesve të punësimit dhe vlerës së investimit të marrë përsipër në momentin e lidhjes së kontratës llogariten penaltitete në vlerën **16,238,155 lekë**, për subjektet si më poshtë:

1. Shoqëria qiramarrëse “**N.-Sh..**” sh.p.k., kundrejt kontratës së qirasë nr. 2304 Rep dhe nr. 777 Kol datë 07.05.2012, të lidhur për objektin “*Ish godina e transformatorëve*”, njësi në administrim të Bashkisë Çorovodë, në zbatim të nenin 5, pika 4, të kontratës së qirasë së sipërcituar, nuk ka realizuar treguesit për investim dhe punësim si detyrimin kontraktor, për rrjedhojë llogariten penaltitete në vlerën **8,260,060 lekë**.

2. Shoqëria qiramarrëse “**S....**” sh.p.k., kundrejt kontratës së qirasë nr. 1606 Rep dhe nr. 326/1 Kol, datë 29.06.2011, të lidhur për objektin: “*Mensë & Guzhinë*”, njësi në administrim të shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” sh.a, Vlorë, në zbatim të nenin 5, pika 7, të kontratës së qirasë së sipërcituar, nuk ka realizuar treguesit për investim dhe punësim si detyrimin kontraktor, për rrjedhojë llogariten penaltitete në vlerën **488,643 lekë**.

3. Shoqëria qiramarrëse “**M..H..**” sh.p.k., kundrejt kontratës së qirasë me nr. 2605 Rep dhe nr. 447 Kol datë 06.07.2010, me aneks kontrate nr. 1738 rep dhe nr. 328-5 Kol. datë 01.04.2011, të lidhur për objektin “*Magazinë dykatëshe*”, me sipërfaqe të përgjithshme 2,509.4 m², njësi në administrim të shoqërisë “*Prodhim veshje Ushtarake*” sh.a. Tiranë, në zbatim të nenin 5, pika 7, të kontratës së qirasë së sipërcituar, nuk ka realizuar treguesit për investim dhe punësim si detyrimin kontraktor, për rrjedhojë llogariten penaltitete në vlerën **450,000 lekë**.

4. Shoqëria qiramarrëse “**K.. F..**” sh.p.k., kundrejt kontratës së qirasë nr. 2624 rep dhe nr. 595/4 Kol datë 24.10.2011, të lidhur për objektin “*Mensa në godinën Nr.1, të Mjekësisë*”, njësi në administrim të shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve Nr. 2*” sh.a, Tiranë, në zbatim të nenin 5, pika 4, të kontratës së qirasë së sipërcituar, nuk ka realizuar treguesit për investim dhe punësim si detyrimin kontraktor, për rrjedhojë llogariten penaltitete në vlerën **125,000 lekë**.

5. Shoqëria qiramarrëse “**I....A**” sh.a., kundrejt kontratës së qirasë nr. 650 rep dhe nr. 133 kol datë 24.03.2000, të lidhur për objektin “*Kinema Republika*” Shkodër, nuk ka realizuar detyrimin kontraktor ndaj MZHETTS, për rrjedhojë llogariten penaltitete në vlerën **150,176 lekë**.

6. Shoqëria qiramarrëse “**I..**” sh.p.k., kundrejt kontratës me qira nr. 2946 rep nr. 154 kol datë 04.06.2002 e ndryshuar, e lidhur me ish METE, me objekt dhënia me qira për objektin “*Parku i Lojërave të Qytetit Vlorë*”, rezulton me detyrime të mëparshme të papaguar, konfirmuar nga Bashkia Vlorë (si njësi administrative monitoruese) me shkresën nr. 3153 prot datë 17.08.2015 drejtuar MZHETTS, ku përcakton vlerën e papaguar të detyrimit në vlerën **6,764,276 lekë**, (Për sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr.68-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e MZHETTS në bashkëpunim me njësitë monitoruese që administrojnë pronën e dhënë me qira, të merren të gjitha masat për arkëtimin e shumës **16,238,155** lekë si vlerë e detyrimeve të papaguara dhe penaliteve të llogaritura nga mosplotësimi i detyrimeve kontraktore nga subjektet (qiramarrëse) si më poshtë:

1-Shoqëria qiramarrëse “**N..-S..**” sh.p.k., në vlerën prej **8,260,060** lekë, penalitete të llogaritura si pasojë e mosplotësimit të treguesit për investim dhe punësim, si detyrim kundrejt kontratës së qirasë nr. 2304 Rep. dhe nr. 777 Kol. datë 07.05.2012, nenin 5, pika 4, të lidhur për objektin “*Ish godina e transformatorëve*” njësi në administrim të Bashkisë Çorovodë.

2-Shoqëria qiramarrëse “**S...**” sh.p.k., në vlerën prej **488,643** lekë penalitete të llogaritura si pasojë e mosplotësimit të treguesit për investim dhe punësim, si detyrim kundrejt kontratës së qirasë nr. 1606 Rep. dhe nr. 326/1 Kol. datë 29.06.2011, nenin 5, pika 7, të lidhur për objektin: “*Mensë &Guzhinë*”, njësi në administrim të shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve*” sh.a., Vlorë.

3-Shoqëria qiramarrëse “**M.. -H...**” sh.p.k. në vlerën prej **450,000** lekë penalitete të llogaritura si pasojë e mosplotësimit të treguesit për investim dhe punësim, si detyrim kundrejt kontratës së qirasë me nr. 2605 Rep. dhe nr. 447 Kol. datë 06.07.2010, me aneks kontrate nr. 1738 rep. dhe nr. 328-5 Kol. dt. 01.04.2011, nenin 5, pika 7, të lidhur për objektin “*Magazinë dykatëshe*”, me sipërfaqe të përgjithshme 2,509.4 m², njësi në administrim të shoqërisë “*Prodhim veshje Ushtarake*” sh.a. Tiranë.

4-Shoqëria qiramarrëse “**K... F...**” sh.p.k., në vlerën prej **125,000** lekë penalitete të llogaritura si pasojë e mosplotësimit të treguesit për investim dhe punësim, si detyrim kundrejt kontratës së qirasë nr. 2624 rep. dhe nr. 595/4 Kol. datë 24.10.2011, nenin 5, pika 4, të lidhur për objektin “*Mensa në godinën Nr.1, të Mjekësisë*”, njësi në administrim të shoqërisë “*Trajtimi i Studentëve Nr. 2*” sh.a, Tiranë.

5-Shoqëria qiramarrëse “**I.....A**” sh.a, në vlerën prej **150,176** lekë për mos plotësimin e detyrimit kontraktor ndaj MZHETTS, kundrejt kontratës së qirasë nr. 650 rep. dhe nr. 133 kol. datë 24.03.2000, të lidhur për objektin “*Kinema Republika*”, Shkodër.

6-Shoqëria qiramarrëse “**I...**” sh.p.k, në vlerën prej **6,764,276** lekë si detyrim i mëparshëm qira e pa paguar kundrejt kontratës nr. 2946 rep nr. 154 kol datë 04.06.2002 e ndryshuar, e lidhur me ish METE, me objekt dhënien me qira të objektit “*Parku i Lojërave të Qytetit Vlorë*”, konfirmuar nga Bashkia Vlorë (si njësi administrative monitoruese) me shkresën nr. 3153 prot. datë 17.08.2015 drejtuar MZHETTS.

Brenda 3/mujorit të parë 2016

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15, germa c, nenin 58 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “*Për nëpunësin civil*”, me ndryshimet i rekomandojmë Ministrit MZHETTS, për shkeljet e konstatuara në monitorimin e objekteve të dhëna me qira, monitorimin dhe arkëtimin e dividendit të japë masë disiplinore duke nisur nga:

“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, deri “Largim nga shërbimi civil” bazuar në përgjegjësitë e cituara gjatë këtij raporti auditimi, për:

Z. A. B, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike për shkeljet e konstatuara:

-Për mos monitorimin e kontratave dhe mos derdhjen e detyrimit të pagesave që shoqëritë me pronar shtet, të cilat sipas kontratave të qirasë kanë detyrimin të derdhin 30% për llogari të MZHETTS, për vitin 2014 dhe për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015 rezultoi e pa likuiduar vlera prej **4,490,655** lekë nga shoqëritë si më poshtë:

“*Prodhim Veshje Ushtarake*” sh.a. Tiranë, rezulton pa likuiduar vlerën prej 1,490,080 lekë,
“*KEPUCA*” sh.a. Korçë, rezulton pa likuiduar vlerën prej 225,360 lekë,

“Uzina 12”, Elbasan, rezulton pa likuiduar vlerën prej 533,666 lekë,

“Prodhim Mobilje” sh.a. Tiranë, rezulton, pa likuiduar vlerën prej 2,241,549 lekë,

-Nga ana e Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike, nuk janë realizuar monitorime fizike në objektet **me qira** për realizimin e treguesve të punësimit dhe investimit, të marrë përsipër në kontratë, si detyrime të subjektit qiramarrës, konkretisht neni 5 (Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit), në nënpikat e kësaj dispozite ligjore ku thuhet se *“Në rast të mos realizimit të treguesve për investimin dhe punësimin sipas pikave (....) të këtij neni, Qiramarrësi detyrohet t’i paguajë Qiradhënësit penaltete në masën 10% të vlerës së investimit të pakryer për çdo vit, deri në realizimin e plotë të tij dhe 50.000 lekë për çdo punonjës të papunësuar”*. Nga auditimi i kontratave qiraje, të pasurisë shtetërore, si rezultat i mosrealizimi të treguesve të punësimit dhe investimit të marrë përsipër në momentin e lidhjes së kontratës llogariten penaltete në vlerën 16,238,155 lekë.

Në kontratat e qirasë, në objektin e shpallur për t’u dhënë me qira, në një pjesë të dosjeve mungojnë planimetritë me përmasat e caktuara të objektit të dhënë me qira.

- MZHETTS dhe Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, si përfaqësuese e vetme e pronarit shtet, nuk ka marrë masat e nevojshme për monitorimin e vazhdueshëm dhe realizimin e arkëtimit të dividendit **të pa derdhur**, nga shoqëritë (sh.a & sh.p.k.) në buxhetin e shtetit, të rezultuar në pasqyrat financiare të vitit 2014, në vlerën 178,842,800 lekë dhe dividendin e pa derdhur në buxhetin e shtetit para vitit 2014, në vlerën 4,516,690,635 lekë.

-Për mangësitë e konstatuara në sektorin e zonave ekonomike në lidhje me mos ndërmarrjen e procedurave për përzgjedhjen e zhvillueseve të rinj në zonat e shpallura me status “zona industriale” të cilat janë jashtë funksionit.

Nga MZHETTS, me shkresën nr. 488/1, dt. 20.01.2016 është kthyer përgjigje, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, brenda afatit ligjor prej 20 ditëve.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Valentina Golemi, përgjegjëse grupi, Nerënxa Llapashtica, Vjollca Selmani dhe Eriola Meçaj, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Zbatimit të Standardeve, Drejtori i Departamentit dhe Drejtori i Përgjithshëm

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT